

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË VANICA SH.P.K.

Sot më datë 1 Dhjetor 2022, Kol Memaj, i biri i Ded Memaj, i datëlindjes 11/04/1981, lindur në Duzhnes Puke, shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë **VANICA sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria **VANICA sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i Vetëm **Kol Memaj**.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **VANICA sh.p.k** do të jetë:

- 1-Prodhim e shitje te mineraleve metalore dhe ndertimore.
- 2-Perpunim te mineraleve metalore dhe ndertimore.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë **VANICA sh.p.k.** do të jetë në Tiranë, në adresën: Tirane Kashar MEZEZ Lagja Fushe Mezez,Rruga Kastriotet,Pallati Alba Konstruksion, zona kadastrale 2679,Nr.pasurie 60/88 - N16.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare **VANICA sh.p.k.** është 500'000 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku i Vetëm themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë **VANICA sh.p.k.** është **Kol Memaj**.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare **VANICA sh.p.k.** në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i Vetëm

Kol Memaj

